



Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	11. 03 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKWSTHK	13/4/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.90/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar i kolegjit, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.90/2022 të datës 03.02.2022 të parashtruar nga ankuesja _____ me adrese _____ në Komunën e Malishevës kundër Aktvendimit me numër 01/134 të datës 31.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës në çështje juridike " Transfer" , duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.90/2022, e datës 03.02.2022, e parashtruar nga ankuesja

II.SHFUQIZOHET Aktvendimi i Kryetarit të Komunës së Malisheve, me numër të protokollit 01/134 të datës 31.01.2022, për transferim të përkohshëm.

III.OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Malishevës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimit, ta kthejë ankuesen në vendin e punës sipas Akt Emërimit të datës 16.07.2020 më të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

IV Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Bazuar në shkresat e lëndës, Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, në Komunën e Malishevës me datë 27.01.2022 me kërkesë i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Malishevës, që kjo drejtori të ndihmohet me staf shtesë për shkak të vëllimit të madh të punëve në këtë drejtori. (janë kërkuar dy zyrtar).

Pas kërkesës së lartë shënuar Kryetari i Komunës së Malishevës me datë 31.01.2022 nxjerr aktvendimin me numër 01/134 përmes të cilit nëpunësen civile e sistemuar në punë dhe detyra të punës "Inspektore të Mjedisit në Drejtorinë e Inspektoratit" në Komunën e Malishevës, duke filluar nga data 01.02.2022 e transferon përkohësisht në pozitën "Zyrtare për Arkë".

Ankuesja e pakënaqur me aktvendimin me numër 01/134 të datës 31.01.2022 të Kryetarit të Komunës me datë 03.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 507/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimore se me rastin e tranferit është bërë shkelje e nenit 52 paragrafi 1 i Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.02.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të organi i punësimi, ndërsa me datë 18.02.2022 Këshilli ka pranuar nga Komuna e Malishevës përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat tjera ndërlihdur me lëndën.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 507/2022 të datës 03.02.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimin me numër 01/134 të datës 31.01.2022 të Kryetarit të Komunës së Malishevës; Dokumentin e identifikimit të ankueses; ID-Kartela e ankueses; Akt emërimit të datës 16.07.2020 me numër 711; Vërtetimin me numër 01/141 të datës 01.02.2022; Kërkesën me numër 04/80 të datës 27.01.2022 të Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi Financa dhe Buxhet; Diplomën me numër 1423 të ankueses me të cilën mori titullin Bachelor i Biologjisë; Diplomën me numër 729 të ankueses me të cilën mori titullin Master i Shkencave të Biologjisë; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 579/2022 të datës 07.02.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 852/2022 të datës 18.02.2022.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstatoj se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesja mbanë pozitën e punës "Inspektore e Mjedisit" në Drejtorinë e inspektoratit në Komunën e Malishevës. E njëjta me aktvendimin me numër 01/134 të datës 31.01.2022 të Kryetarit të Komunës është transferuar në pozitën e punës "Zyrtare për Arka" pranë Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet në Komunën e Malishevës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të provave të lëndës, ka konstatuar se bazuar në përshkrimin e detyrave të punës, respektivisht Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, po ashtu edhe duke i'u referuar Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pozita Inspektor i Mjedisit të cilën e mban ankuesja hyn në grupin e pozitave Specialistë të Përgjithshëm të Mjedisit ku përgatitja profesionale e arsimit kërkohet: "Inxhinieri Mjedisi/ Mjedisi/ Kimi e Përgjithshme, Ekologji dhe të

ngjashme", ndërsa pozita ku është transferuar ankuesja "Zyrtare për Arka", hyn në grupin e pozitive Specialistë të Përgjithshëm të Tatim-Taksave apo mbledhjes të të ardhurave ku përgatitja profesionale e arsimit kërkohet: *"Drejtësi/ Ekonomik (pavarësisht nga specialiteti)"*, ndërsa në bazë të provave të lëndës të bashkangjitur nga palët në porcedurë, ankuesja posedon diplomën *Bachelor i Biologjisë-Ekologji dhe Mbrojtje të Mjedisit* si dhe diplomën e studimeve Master i Shkencave të Biologjisë.

Bazuar në këtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se përgatitja profesionale e ankueses nuk është e përshtatshme me përgatitjen respektivisht përshkrimin e detyrave të punës në pozitën që është transferuar "Zyrtare për Arka", kështu që në kuptim të nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, përcaktohet se: *"...Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet"*, në këtë rast nuk është bërë analizë e saktë e plotësimit të kushteve për transferim, andaj edhe Aktvendimi i Kryetarit të Komunës së Malisheve, me numër të protokollit 01/134 të datës 31.01.2022, për transferim të përkohshëm të ankueses është në kundërshtim me këtë frymë.

Sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, arsyetimi i Aktvendimi i Kryetarit të Komunës së Malisheve, me numër të protokollit 01/134 të datës 31.01.2022, për transferim të përkohshëm të ankueses është i pa qartë dhe kontradiktor dhe në kundërshtim, sepse është marr pa u mbështetur në asnjë provë juridike dhe është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe po ashtu në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni i cili përcakton se: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*. Po ashtu sipas këtyre Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Aktvendimi i Kryetarit të Komunës së Malisheve, me numër të protokollit 01/134 të datës 31.01.2022, për transferim të përkohshëm të ankueses është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafët 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj anulimi i këtij vendimi bëhet me qëllim për të vendosur ligjshmërinë siç parashihet me nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë"*.

Bazuar në të lartcekurat, Kryetari i Komunës së Malishevës, është e obliguar që ankuesen ta kthej në vendin e punës Inspektore e Mjedisit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës që rrjedhin sipas akt emërimit.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.90/2022.

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procsmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

